



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 26, dt. 10. 06.2024

MBI
NDYSHIMIN E EMËRTIMEVE TË FUNKSIONARËVE NË KABINETIN E
KRYETARIT

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 97, datë 07.12.2023 “Për Buxhetin e Vitit 2024”, ligjin nr. 8095, datë 21.03.1996 “Për Shërbimin Civil” i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM-së nr. 625, datë 28.09.2022, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet në emërtimin e funksionarëve të Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë si më poshtë:
 - a) *Drejtor i Kabinetit të Kryetarit – Këshilltar juridik*, do të mbajë emërtimin në Strukturën organizative të administratës të Këshillit të Qarkut Korçë:
“Drejtor i Kabinetit të Kryetarit”.
 - b) *Këshilltar për teknologjinë dhe komunikimin*, do të mbajë emërtimin në Strukturën organizative të administratës të Këshillit të Qarkut Korçë:
“Këshilltar i Kryetarit”.
 - c) *Këshilltar për projektet e bashkimit europian*, do të mbajë emërtimin në Strukturën organizative të administratës të Këshillit të Qarkut Korçë:
“Këshilltar i Kryetarit”.
2. Ndryshimet në emërtimin e funksionarëve të Kabinetit nuk do të kenë efekte financiare në buxhetin e vitit 2024.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Erjon Nexhipi

Miratuar me / 15 / Vota
Vota Pro / 15 /
Vota Kundër / 0 /
Vota Astenim / 0 /
Zbardhur më datë /10/06/2024

Konceptoi : R. Latollari

Konfirmoi : M. Bylykbashi

Pranoi : Sek. KQK B. Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI

NDYSHIMIN E EMËRTIMEVE TË FUNKSIONARËVE NË KABINETIN E KRYETARIT

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, pika ç, ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 21, ligjit nr. 97, datë 07.12.2023 "Për Buxhetin e Vitit 2024", ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, Ligjin Nr. 8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar, VKM-së nr. 625, datë 28.09.2022, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 165, datë 02.03.2016, "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", si dhe VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", Kabineti i kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë, si strukturë ndihmëse është e përbërë nga funksionarë të emëruar, të cilët ushtrojnë veprimtari të drejtpërdrejtë ndihmëse për realizimin e funksioneve politike sipas parashikimeve të nenit 13, të Ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar, emërtimet e funksionarëve të Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë do të jenë si më poshtë :

1. *Drejtor i Kabinetit të Kryetarit – Këshilltar juridik*, do të mbajë emërtimin në Strukturën organizative të administratës të Këshillit të Qarkut Korçë:
"Drejtor i Kabinetit të Kryetarit".
2. *Këshilltar për teknologjinë dhe komunikimin*, do të mbajë emërtimin në Strukturën organizative të administratës të Këshillit të Qarkut Korçë:
"Këshilltar i Kryetarit".
3. *Këshilltar për projektet e bashkimit evropian*, do të mbajë emërtimin në Strukturën organizative të administratës të Këshillit të Qarkut Korçë:
"Këshilltar i Kryetarit".

I propozojmë Këshillit të Qarkut Korçë, miratimin e ndryshimeve në emërtimin e funksionarëve të Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë.

- Pozicionet e sipërcituara do të specifikohen dhe përditësohen me përshkrimet përkatëse të pozicioneve të punës, në Strukturën organizative të administratës, si dhe në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin administratës së Këshillit të Qarkut Korçë, të miratuar me vendimin nr. 06, datë 15.03.2024.

- Niveli i pagave nuk do të pësojë ndryshime për pozicionet e sipërcituara.

Sa më sipër kërkojmë miratim e ndryshimeve në emërtimin e pozicionit të funksionarëve në Kabinetin e Kryetarit.

Korçë, më 03.06.2024

ZYRA E SHËRBIMEVE, BURIMEVE NJERËZORE
DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Redin Latollari

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ADMINISTRATËS TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2024

VKM nr. 328, dt. 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore"

Nr.	Njësia strukturore	Nr. Punonjësve	Kategoria	Grupi i diplomës	Shtesa e nivelit të kualifikimit	Vjetërsi	Paga e pozicionit	Statusi i punonjesit
I	Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	Lidhja 1/e				170000	Të zgjedhur
II	Zvendëskryetar i Këshillit të Qarkut	1	Lidhja 1/e				125000	Të zgjedhur
III	Sekretar i Këshillit të Qarkut	1	Lidhja 8, I-b	1	14000	2%	100500	Të emëruar nga Këshilli i Qarkut
IV	Kabineti i Kryetarit							
	Drejtor i kabinetit të kryetarit	1	Lidhja 8, I-b	1	14000	2%	112500	Pozicion pune i emëruar nga Kryetari mbështur në nenin 13, të Ligjit nr.8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar.
	Këshilltar i Kryetarit	1	Lidhja 8, II-b	1	14000	2%	85000	Pozicion pune i emëruar nga Kryetari mbështur në nenin 13, të Ligjit nr.8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar.
	Këshilltar i Kryetarit	1	Lidhja 8, II-b	1	14000	2%	91000	Pozicion pune i emëruar nga Kryetari mbështur në nenin 13, të Ligjit nr.8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar.
V	Spektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit							
	Përgjegjes i Sektorit të Financës dhe Buxhetit	1	Lidhja 8, III-a/1	1	14000	2%	80300	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për Shërbimet, Burimet Njerëzore dhe Emergjencat Civile	1	Lidhja 8, III-b	1 ose 2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Territorit	1	Lidhja 8, III-b	1 ose 2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për programet e zhvillimit	1	Lidhja 8, III-b	1 ose 2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist për Shëndetsinë dhe Çështjet sociale, arsimin dhe Kulturën	1	Lidhja 8, III-b	1 ose 2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
VI	Punonjës administrativë							
	Shofer autoveture i institucionit	1	Pika 11 dhe 12			1%	47000	Pozicion pune me kontratë
	Totali Administrata	13						

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Erjon Nexhipi

